LIGJ
Nr.10 223, datë 4.2.2010

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PARREGULLT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për ripranimin e personave me qëndrim të parregullt".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6424, datë 16.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS
PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PARREGULLT

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës (të quajtura më poshtë "Palë Kontraktuese"),

Me dëshirën për të pasur marrëdhënie miqësore midis dy shteteve;

Me dëshirën për të bashkëpunuar në ripranimin e personave që kanë hyrë ose qëndrojnë në mënyrë të parregullt;

Me dëshirën për të kontribuar në parandalimin e lëvizjes së paligjshme të personave dhe në përputhje me parimet e bashkëpunimit europian, si dhe në përputhje me interesat dypalëshe,

kanë rënë dakord si vijon:

I
PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Ripranim” do të thotë transferimi nga pala kërkuese dhe pranimi drejt palës që i drejtohet kërkesa të personave (shtetas të palës që i drejtohet kërkesa ose qytetarë të vendeve të treta, ose persona pa shtetësi), të cilët kanë hyrë, qëndrojnë ose banojnë në palën kërkuese, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

b “Shtetas i Republikës së Shqipërisë” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar;

c) “Shtetas i Bosnjës dhe Hercegovinës” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Bosnjës dhe Hercegovinës, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar;

d) “Shtetas i vendit të tretë” do të thotë çdo person i cili mban shtetësi të ndryshme nga ajo e Shqipërisë dhe Bosnje-Hercegovinës;

e) “Person pa shtetësi” do të thotë çdo person i cili nuk zotëron një shtetësi;

f) “Leje qëndrimi” do të thotë një leje e çdo tipi e lëshuar nga Republika e Shqipërisë ose Bosnja dhe Hercegovina, që i jep të drejtë një personi të qëndrojë në territorin e saj. Kjo nuk do të përfshijë lejet e përkohshme për të qëndruar në territorin e saj në lidhje me procedurat e aplikimit për azil ose një aplikimi për leje qëndrimi;

g) “Vizë” do të thotë një autorizim për të hyrë, qëndruar ose kaluar përmes territorit të saj, lëshuar nga njëra prej palëve kontraktuese, kjo nuk do të përfshijë vizën e tranzitit aeroportual;

h) “Shtet kërkues” do të thotë shteti që dorëzon një aplikim ripranimi, pranimi ose tranzitimi;

i) “Shtet i kërkuar” do të thotë shteti të cilit i drejtohet aplikimi për ripranim, pranim ose tranziti;

j) “Autoriteti kompetent” do të thotë çdo autoritet kombëtar përgjegjës për implementimin e kësaj Marrëveshje;

k) “Tranzit” do të thotë kalimi i një qytetari të një vendi të tretë ose personi pa shtetësi përmes territorit të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa, ndërsa udhëton nga shteti kërkues drejt vendit të destinacionit.

II
RIPRANIMI I SHTETASVE TË SHTETEVE TË PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 2

1. Secila palë kontraktuese pranon në territorin e shtetit të saj, me kërkesën e palës tjetër kontraktuese, dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të cituara në këtë Marrëveshje, personin që qëndron në mënyrë të parregullt në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese, nëse provohet ose prezumohet në mënyrë të vlefshme se personi zotëron shtetësinë e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar.

2. Secila palë kontraktuese do të pranojë gjithashtu fëmijë minorenë të personave referuar në paragrafin 1 të këtij neni, pavarësisht vendlindjes së tyre dhe shtetësisë, përveç nëse kanë të drejtë të pavarur të qëndrojnë në palën kontraktuese kërkuese.

3. Pala kontraktuese kërkuese ripranon personin të referuar në paragrafin 1 dhe 2, sipas të njëjtave dispozita, nëse më vonë, në bazë të hetimeve të mëtejshme, përcaktohet se në kohën kur ai/ajo u transferua nga territori i shtetit të palës kërkuese, ai/ajo referuar paragrafit 1 të këtij neni nuk e zotëronte shtetësinë e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar.

4. Në rast të transferimit të personit referuar paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, që ka nevojë për kujdes të veçantë për arsye të moshës së tij/saj, gjendjes së keqe shëndetësore ose për ndonjë arsye tjetër të rëndësishme, çdo palë kontraktuese informon për këtë palën tjetër.

Neni 3

1. Pasi pala kontraktuese e kërkuar dërgon një përgjigje pozitive për kërkesën e ripranimit, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar, me kërkesë të palës kontraktuese kërkuese, lëshon pa vonesë dhe brenda 7 ditëve një dokument zëvendësues udhëtimi falas që është i nevojshëm për kthimin e personit që transferohet në përputhje me nenin 2, paragrafi 1 dhe 2. Edhe nëse brenda 7 ditëve kërkesa nuk është realizuar, të dyja palët mund të përdorin dokumente standarde udhëtimi për ripranimin i cili është pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

2. Kur ka dyshime për vlefshmërinë e shtetësisë së prezumuar, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar interviston personin brenda shtatë (7) ditëve nga dorëzimi i aplikimit për pranimin e personit. Me miratimin e misionit diplomatik ose autoritetit konsullor, pala kontraktuese kërkuese do ta mundësojë këtë intervistë brenda një kohe sa më të shkurtër. Nëse ky shqyrtim tregon se personi zotëron shtetësinë e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar, misioni diplomatik apo autoriteti konsullor do të lëshojë menjëherë një dokument zëvendësues udhëtimi.

III
RIPRANIMI I SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 4

1. Nëse personi që ka hyrë në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese nuk arrin të përmbushë kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim, dhe nëse ky person ka një vizë të vlefshme ose një leje të vlefshme qëndrimi, të lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar, kjo e fundit e ripranon atë me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2. Nëse të dyja palët kontraktuese lëshuan një vizë ose një leje qëndrimi, detyrimi për ta pranuar do të jetë i asaj pale kontraktuese për të cilën vlefshmëria e vizës ose lejes së qëndrimit skadon më vonë.

Neni 5

1. Pala kontraktuese e kërkuar pranon shtetas të vendeve të treta apo persona pa shtetësi me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese, nëse kjo e fundit provon apo prezumon në mënyrë të vlefshme se personi, i cili nuk i plotëson kërkesat efektive për hyrje apo qëndrim, e ka kaluar kufirin shtetëror të shtetit të palës kontraktuese kërkuese, pasi ka qëndruar ose ka kaluar përmes territorit të shtetit të palës kontraktuese të kërkuar.

2. Detyrimi për të ripranuar sipas paragrafit 1, nuk zbatohet ndaj një personi, i cili në kohën e hyrjes në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese kishte një leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga ajo palë kontraktuese, ose të cilit i ishte dhënë lejeqëndrimi nga ajo palë kontraktuese pas hyrjes së tij/saj, përveç:

- Nëse ai person kishte një vizë ose lejeqëndrimi me periudhë më të gjatë vlefshmërie, të lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar, ose
- Nëse viza ose leja e qëndrimit ishte lëshuar në shtetin e palës kontraktuese kërkuese, në bazë të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara ose deklaratave të rreme.

3. Pala kontraktuese kërkuese ripranon një shtetas të një shteti të tretë ose një person pa shtetësi, nën të njëjtat kushte, nëse më pas përcaktohet se në kohën e transferimit të tij/saj nga territori i shtetit të palës kontraktuese kërkuese nuk plotësoheshin kushtet e nenit 4, paragrafi 1 dhe nenit 5 paragrafi 1.

Neni 6

Detyrimi për të ripranuar, në përputhje me nenet 4 dhe 5, nuk zbatohet për një shtetas nga vendet e treta ose për një person pa shtetësi:

a) të cilit i është dhënë statusi i refugjatit nga pala kontraktuese kërkuese, në bazë të Konventës për Statusin e Refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951) dhe Protokollit për Statusin e Refugjatëve (Nju Jork, 31 janar 1967);

b) i cili është në procedurë të njohjes nga pala kontraktuese kërkuese lidhur me mbrojtjen ndërkombëtare deri në vendimmarrjen ekzekutive;

c) i cili është transferuar paraprakisht nga pala kontraktuese e kërkuar për në shtetin e origjinës ose ndonjë shtet tjetër, dhe i cili më pas hyri në territorin e palës kontraktuese kërkuese nga territori i shtetit të tretë.

IV
PROCEDURAT

Neni 7

1. Procedura e ripranimit fillohen nga pala kontraktuese duke dorëzuar një kërkesë për ripranim për shtetas të palës kontraktuese ose kërkesë për ripranim të shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi.

2. Nuk do të nevojitet aplikim ripranimi kur personi që do të ripranohet zotëron një dokument të rregullt udhëtimi ose kur është e mundur një vizë e vlefshme ose lejeqëndrimi për në palën kontraktuese të kërkuar.

3. Pala kontraktuese e kërkuar, referuar në paragrafin 1 të këtij neni, do t'i përgjigjet palës kontraktuese kërkuese.

4. Do të jepen arsyet për refuzimin e një kërkese ripranimi.

5. Pala kontraktuese që transferon një person, do të lajmërojë kohën e transferimit të tij/saj, pikën e kalimit kufitar dhe shoqëruesit e mundshëm dhe pala kontraktuese e kërkuar do ta konfirmojë ripranimin e tij/saj.

6. Dorëzimi i një kërkese për ripranim dhe përgjigjja e saj, si dhe njoftimi i pranimit ose jo të tij, do t'u dërgohet direkt autoriteteve kompetente në formë elektronike, faks ose me postë të rregullt.

7. Transporti mund të bëhet në rrugë ajrore ose tokësore.

V
AFATET KOHORE

Neni 8

1. Aplikimi për ripranim duhet t'i dorëzohet autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar, maksimumi 180 ditë, pasi autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese është vënë në dijeni se një shtetas i një prej palëve kontraktuese ose i një vendi të tretë, ose një person pa shtetësi nuk plotëson, ose nuk plotëson më, kushtet në fuqi për të hyrë, qëndruar ose banuar në të. Kur ka pengesa ligjore ose faktike për dorëzimin e aplikimit në kohë, afati kohor do të zgjatet me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese derisa pengesat të kenë pushuar së ekzistuari.

2. Një aplikim ripranimi kërkon përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike në të gjitha rastet. Kjo kohë fillon që nga data e marrjes së kërkesës së ripranimit. Nëse nuk do të ketë përgjigje brenda këtij afati, transferimi do të quhet si i pranuar.

3. Kur ka pengesa ligjore ose faktike për t'iu përgjigjur aplikimit brenda 10 ditëve kalendarike, ky afat kohor do të zgjatet, sipas kërkesës së motivuar në një maksimum prej 6

ditësh kalendarike. Nëse nuk do të ketë përgjigje brenda këtij afati të zgjatur kohor, transferimi do të quhet i pranuar.

4. Pala kontraktuese kërkuese do të njoftojë për transferimin e një personi 72 orë para transferimit të tij/saj dhe pala kontraktuese e kërkuar do të konfirmojë ripranimin në kohën më të shkurtër të mundur, por jo më vonë se 48 orë pas marrjes së njoftimit të transferimit. Nëse nuk do të ketë përgjigje mbi konfirmimin e pranimit brenda këtij afati kohor, transferimi do të quhet i pranuar.

VI
TRANZITI

Neni 9

1. Secila palë kontraktuese lejon tranzitin e një shtetasi të një pale të tretë ose një personi pa shtetësi, përmes territorit të shtetit të saj, në qoftë se kjo kërkohet me shkrim nga pala tjetër kontraktuese, pasi pala kontraktuese që dorëzon një aplikim tranziti ka siguruar pranimin në shtetin e destinacionit dhe tranzitit përmes shteteve të tjera. Në këto raste pala kontraktuese që pranon kërkesën e tranzitit përmes territorit të saj nuk duhet të kërkojë vizë tranziti për qytetarë të vendeve të treta ose persona pa shtetësi për të cilët tranziti është aprovuar.

2. Pala kontraktuese kërkuese do t'i garantojë palës kontraktuese të kërkuar se personi, tranziti i të cilit lejohet, ka një biletë udhëtimi dhe një dokument të vlefshëm udhëtimi për në shtetin e destinacionit.

3. Pala kontraktuese që merr aplikimin për tranzit, brenda 5 ditëve kalendarike do të informojë me shkrim palën kontraktuese që kërkon tranzitin, duke konfirmuar datën dhe pikën kufitare hyrëse për në vend, ose të informojë për refuzimin e tranzitit dhe për arsyet e refuzimit.

4. Në rast të tranzitit në rrugë ajrore me shoqërimin e një eskorte policore, pala kontraktuese kërkuese siguron këtë shoqërim deri në aeroportin e palës kontraktuese të kërkuar, me kusht që eskorta policore të mos largohet përtej zonës ndërkombëtare të aeroportit. Nëse tranziti me eskortë policore vazhdon përmes territorit të palës kontraktuese të kërkuar, ajo palë kontraktuese siguron eskortën policore.

5. Pala kontraktuese kërkuese ka përgjegjësinë për pranimin e personit për në vendin e destinacionit dhe vendet e tranzitit dhe personi do të ripranohet nëse ripranimi i tij/saj refuzohet në shtetin e destinacionit ose shtetet e tjera të tranzitit.

Neni 10

1. Tranziti mund të refuzohet nëse një shtetas i një vendi të tretë ose person pa shtetësi është në rrezik:

a) të jetë subjekt torture ose trajtimi çnjerëzor, degradues ose ndëshkim, ose dënimi me vdekje ose persekutim në shtetin e destinacionit për arsye race, feje, kombësie, anëtarësie në një grup shoqëror të caktuar ose për arsye të opinioneve të tij/saj politike në shtetin e destinacionit ose një shteti tjetër tranziti, ose

b) të ndjekjes penale në shtetin e destinacionit ose ekzekutimin e një dënimi të dhënë për një vepër penale të kryer para se të ndodhte tranziti, ose

c) të ndjekjes penale në shtetin e destinacionit ose ekzekutimin e një dënimi të dhënë për një vepër penale të kryer para se të ndodhte tranziti, me përjashtim të rasteve të kalimit të paligjshëm të kufijve shtetërorë.

2. Tranziti i shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi mund të refuzohet mbi bazën e deportimit dhe hyrjes së ndaluar në fuqi, shëndetit publik, sigurisë së brendshme, rendit publik dhe interesave kombëtarë të shtetit të kërkuar.

3. Një person që pranohet për tranzit mund t'i kthehet palës kontraktuese kërkuese, nëse faktet e përmendura në paragrafin 1 dhe 2 vërtetohen më pas.

VII
RIMBURSIMI I SHPENZIMEVE

Neni 11

1. Shpenzimet e lidhura me ripranimin e personave deri në kufi, në zbatim të nenit 2, paragrafi 1 dhe 2, nenit 4 paragrafi 1 dhe nenit 5, paragrafi 1 të palës kontraktuese të kërkuar mbulohen nga pala kontraktuese kërkuese. Shpenzimet, në lidhje me kthimin e mundshëm të personave për t'u ripranuar, mbulohen gjithashtu nga pala kontraktuese kërkuese.

2. Shpenzimet e kalimit tranzit të një shtetasi të një pale të tretë deri në kufirin e shtetit të destinacionit, duke përfshirë edhe shpenzimet që lidhen me tranzitin përmes territorit të palës kontraktuese të kërkuar, sikurse edhe shpenzimet që lidhen me një kthim të mundshëm të tij/saj mbulohen nga pala kontraktuese kërkuese.

VIII
MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 12

1. Të dhënat personale të komunikuara, të cilat janë të nevojshme për të realizuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, mbrohen në përputhje me rregullat ligjore kombëtare të shteteve të palëve kontraktuese.

2. Nëse zbatimi i kësaj Marrëveshjeje kërkon shkëmbim të dhënash personale të personit, ndërmjet palëve kontraktuese, këto të dhëna mund të jenë vetëm në lidhje me:

a) të dhënat personale të personit që duhet të transferohet ose të ripranohet, të të afërmve të tij/saj (p.sh. emri, mbiemri, emra të mëparshëm, pseudonime, emra të rremë, data dhe vendi i lindjes, gjinia, shtetësia aktuale dhe të mëparshmet);

b) pasaportën, kartën e identitetit, dokumente të tjera identiteti, ose dokumente udhëtimi dhe lejekalimi (numri, data e skadimit, data e lëshimit, organi lëshues, vendi i lëshimit);

c) të dhëna të tjera të nevojshme për të identifikuar personin që do të transferohet apo do të pranohet (p.sh. foto, shenja gishtërinjsh);

d) vendin e qëndrimit dhe rrugën (itinerari);

e) lejeqëndrimin apo vizën.

3. Të dhënat personale duhet të merren për qëllimin e specifikuar, të qartë dhe ligjor të implementimit të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk do të përdoren më nga autoritetet komunikuese ose marrëse në një mënyrë që nuk ka të bëjë me këtë qëllim.

4. Të dhënat personale mund t’u komunikohen vetëm autoriteteve kompetente për implementimin e kësaj Marrëveshjeje, të cilët do të jenë të vetmit që do t’i përdorin në mënyrë që t’u ndalohet hyrja personave të paautorizuar. Komunikime të mëtejshme për organe të tjera kërkojnë miratimin paraprak të autoritetit komunikues.

5. Pala kontaktuese që komunikon të dhënat garanton se ato janë të sakta, të nevojshme dhe në përputhje me qëllimin e komunikimit. Nëse të dhënat nuk janë të sakta ose janë komunikuar në mënyrë të paligjshme, pala kontraktuese marrëse duhet të informohet menjëherë në mënyrë që t’i shkatërrojë ato.

6. Me kërkesë personale çdo person informohet për komunikimin e të dhënave që kanë të bëjnë me të duke përfshirë qëllimin e tyre.

7. Të dhënat personale të komunikuara do të mbahen për periudhën kohore aq gjatë sa është e nevojshme, në përputhje me qëllimin e komunikimit.

8. Komunikimi dhe autoritetet marrëse janë nën detyrimin për të mbajtur kopje të komunikimit dhe marrjes së të dhënave personale.

IX
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13

1. Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Sigurisë e Bosnjës dhe Hercegovinës do të përfundojnë një protokoll zbatimi në të cilin ata specifikojnë:

a) dokumentet që provojnë apo prezumojnë në mënyrë të vlefshme shtetësinë e palëve kontraktuese;

b) përgatitjen e kërkesave për ripranimin dhe tranzitin, mënyrën e paraqitjes dhe shqyrtimit të tyre;

c) mjete për të provuar apo për të prezumuar në mënyrë të vlefshme hyrjen apo qëndrimin në territorin e shtetit të palës kontraktuese;

d) autoritetet kompetente të autorizuara për ta zbatuar këtë Marrëveshje;

e) pikat e kalimit kufitar të përdorura për zbatimin e Marrëveshjes.

Neni 14

1. Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese të autorizuara për ta zbatuar këtë Marrëveshje bashkëpunojnë dhe konsultohen drejtpërsëdrejti.

2. Në rast vështirësish, në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, kërkesa për konsultim duhet të paraqitet përmes kanaleve diplomatike.

3. Secila palë kontraktuese cakton të paktën dy ekspertë për të vlerësuar zbatimin e marrëveshjes dhe nëse është e nevojshme paraqet propozime për zgjidhjen e çështjeve që lidhen me zbatimin e saj. Në të tilla shqyrtime mund të ftohen edhe ekspertë të tjerë.

Neni 15

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk përmbajnë paragjykime për të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese që lindin nga ligjet ndërkombëtare dhe veçanërisht, nga

- Konventa e 28 korrikut 1951 mbi statusin e refugjatëve, të amenduar me protokollin e 31 janarit 1967 mbi statusin e refugjatëve;
- Konventës europiane të 4 nëntorit 1950 për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
- Konventën e 10 dhjetorit 1984 kundër torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues ose ndëshkimit;
- Konventa ndërkombëtare mbi ekstradimin dhe tranzitin;
- Marrëveshje të tjera ndërkombëtare mbi ripranimin e shtetasve të huaj.

Neni 16

1. Kjo Marrëveshje firmoset për një periudhë kohe të pacaktuar. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e parë të muajit që ndjek shkëmbimin e njoftimit nëpërmjet të cilit palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave kombëtare të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Marrëveshja do të zbatohet provizorisht që nga data e nënshkrimit.

3. Secila palë kontraktuese mund ta pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, tërësisht apo pjesërisht, me përjashtim të nenit 2, për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, rendit publik dhe shëndetit publik. Palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën pa vonesë për marrjen e kësaj mase apo për anulimin e saj nëpërmjet kanaleve diplomatike. Pezullimi i zbatimit të

Marrëveshjes do të hyjë në fuqi me dorëzimin e njoftimit palës tjetër kontraktuese.

4. Secila palë kontraktuese mund ta denoncojë me shkrim Marrëveshjen nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja skadon në ditën e nëntëdhjetë (90-të) pas dorëzimit të njoftimit të përfundimit.

Bërë më _____ në _____ në dy origjinale, secila prej të cilave në gjuhën shqipe, në gjuhët zyrtare të Bosnjës dhe Hercegovinës (boshnjake, kroate dhe serbe) dhe në gjuhën angleze, të gjitha tekstet autentike dhe të vlefshme ligjërisht. Në rast keqinterpretimi, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

PROTOKOLL
NË ZBATIM TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS
MBI RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PARREGULLT

Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës (më poshtë referohen si "Palët Kontraktuese"),

në vijim të nenit 13 të Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, mbi ripranimin e personave me qëndrim të parregullt, përfunduar në--------më ---------- (më poshtë referuar "Marrëveshje"), me qëllim për të bërë efektive dhe lehtësuar zbatimin e Marrëveshjes,

ranë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1
Vendosja dhe vlefshmëria e shtetësisë

1. Sipas kësaj Marrëveshjeje shtetësia e një personi vendoset në bazë të dokumenteve të vlefshme të mëposhtme:

Për shtetësinë shqiptare me anë të:

a) kartës së identitetit;

b) certifikatës së lindjes me fotografi/lejekalimi;

c) pasaportë e çdo lloji;

d) libreza e shërbimit ushtarak;

e) patentë për drejtimin e automjetit.

Për shtetësinë e Bosnje-Hercegovinës me anë të:

a) Pasaportës (diplomatike, shërbimi, personale dhe pasaporta kolektive);

b) Karta e identitetit (lëshuar nga projekti CIPS);

c) Certifikata e shtetësisë me dokumente zyrtare të tjera të vlefshme me fotografi.

1. Shtetësia provohet pa nevojën e hetimit të mëtejshëm, kur paraqiten prova të vlefshme që referohen në paragrafin 1 të këtij neni.

2. Shtetësia e personit që do të transferohet, në përputhje me nenin 2 të Marrëveshjes, bëhet e vlefshme me anë të dokumenteve të mëposhtme:

a) Një dokumet me afat të mbaruar referuar në paragrafin 1 të këtij protokolli;

b) Libreza e shërbimit ushtarak ose një tjetër dokument identiteti, lëshuar nga anëtarët e forcave të armatosura;

c) Libreza e marinarit;

d) Certifikata e lindjes, martesës;

e) Patentë për drejtim automjeti;

f) Çdo dokument i lëshuar nga autoritetet kompetente;

g) Një fotokopje të dokumenteve të lartpërmendura, si dhe dokumentet me afat të përfunduar;

h) Një deklaratë zyrtare nga personi ose një dëshmitar.

3. Shtetësia do të konsiderohet e vlefshme nga palët kontraktuese, vetëm nëse caktohet ndryshe nga palët kontraktuese të kërkuara.

4. Nëse palët kontraktuese të kërkuara e ripranojnë personin, për shkak se më pas vendoset se ai/ajo nuk ka zotëruar kombësinë e shtetit të palëve kontraktuese të kërkuara, duhet t'u kthejë palëve kontraktuese kërkuese të gjitha dokumentet që zotëron të personit të ripranuar.

Neni 2

Aplikimi për ripranimin e qytetarit të shtetit të palëve kontraktuese dhe kërkesat për paraqitjen e tyre

1. Aplikimet e paraqitura për ripranimin e qytetarit të palëve kontraktuese në vijim të nenit 2 të Marrëveshjes duhet të përmbajnë, në veçanti, informacionin e mëposhtëm:

a) Të dhënat e identitetit të personit që do të ripranohet;

b) Veçantitë me dokumentet e referuara në nenin 1 të këtij protokolli, që lejojnë vërtetimin ose vlefshmërinë e qytetarisë së personit që do të ripranohet;

c) Të dhëna mbi fëmijë minorenë që do të rikthehen me prindërit;

d) Një foto e personit që do të ripranohet;

e) Informacion mbi nevojën për sigurimin e personit që do të ripranohet me kujdes shëndetësor të veçantë ose lloj tjetër kujdesi.

2. Aplikimi për ripranim do të dërgohet menjëherë për autoritetet e specifikuara në nenin 7 të këtij protokolli, veçanërisht me anë të: e-mail, fax ose postë normale.

3. Transferimi i personit që do të ripranohet do të bëhet vetëm me marrjen e miratimit të palës shtetërore të kërkuar për pranim, ose pas afatit të mbaruar të përcaktuar nga kjo Marrëveshje.

Neni 3

Aplikimi për ripranimin e shtetasve nga vendet e treta dhe shtetasve pa shtetësi dhe kushtet për paraqitjen e tij

1. Aplikimi i paraqitur për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi në vijim të dispozitave të nenit 4 dhe 5 të Marrëveshjes, duhet të përmbajë, në veçanti, informacionin e mëposhtëm:

a) Të dhënat mbi identitetin e personit që do të ripranohet, dhe aty ku është e nevojshme të dhënat mbi fëmijët minorenë që kthehen së bashku me prindërit;

b) Veçantitë në lidhje me dokumentet e referuara në nenin 3 dhe 4 të këtij protokolli që lejojnë vërtetimin dhe vlefshmërinë e hyrjes ose qëndrimit, ose tranzitit të personit që do të ripranohet në territorin e shtetit të palëve kontraktuese të kërkuara;

c) Fotografi e personit që do të pranohet;

d) Informacion mbi nevojën për sigurimin e personit që do të ripranohet me kujdes shëndetësor të veçantë ose lloj tjetër kujdesi.

2. Aplikimi për ripranim do të dërgohet menjëherë për autoritetet e specifikuara në nenin 7 të këtij protokolli, veçanërisht me anë të: e-mail, fax ose postë normale.

3. Pala kontraktuese e kërkuar duhet t'i dorëzojë palës kontraktuese kërkuese miratim me shkrim për ripranimin e personit.

4. Transferimi i personit që do të ripranohet do të bëhet vetëm kur të ketë mbaruar afati i përcaktuar në marrëveshje.

Neni 4

Vendosja dhe vlefshmëria e qëndrimit ose tranzitit përmes territorit të palëve kontraktuese

1. Hyrja e një shtetasi të vendeve të treta ose një personi pa shtetësi, qëndrimi i tij/saj aty ose tranziti përmes territorit të palëve kontraktuese të kërkuara, në vijim të nenit 4 dhe 5 të Marrëveshjes mund të vendoset në bazë të dokumenteve të mëposhtme:

a) Vula e hyrjes ose daljes ose të dhëna të tjera të regjistruara nga autoritetet e palëve kontraktuese të kërkuara në dokumentet e udhëtimit ose dokumentet e tjera identifikuese;

b) Vula e daljes së autoritetit të palës kontraktuese të kërkuar në dokumentin e udhëtimit të falsifikuar;

c) Lejeqëndrimi e vlefshme nga pala kontraktuese e kërkuar;

d) Vizë e vlefshme lëshuar nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar;

e) Dokumentet e identifikimit lëshuar nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar;

f) Dokumente të vlefshme të azilkërkuesve ose dokument refugjati, ose dokument i vlefshëm udhëtimi si refugjat, ose fotokopje e këtyre dokumenteve;

g) Bileta udhëtimi të përdorura me emrin e përmendur, që sigurojnë hyrjen e personit në territorin e palës kontraktuese të kërkuar.

2. Dokumentet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, shërbejnë si provë indirekte qëndrimi ose tranziti përmes territorit të shteteve të palëve kontraktuese.

3. Hyrja e shtetasve nga vendet e treta ose personave pa shtetësi, qëndrimi i tij/saj aty ose tranziti përmes territorit të palës kontraktuese të kërkuar, në vijim të nenit 4 dhe 5 të Marrëveshjes mund të jetë i vlefshëm në bazë të fakteve të mëposhtme:

a) lejet e qëndrimit të lëshuara nga autoriteti i palës kontraktuese të kërkuar dhe vlefshmëria e të cilave ka përfunduar ose fotokopje;

b) viza e përfunduar ose fotokopja e saj;

c) dokumentet e refugjatit, vlefshmëria e të cilave ka përfunduar (dokument i azilkërkimit, dokumentet e refugjatit ose dokumentet e udhëtimit të refugjatit) ose fotokopjet;

d) dokumentet zyrtare të autoriteteve kompetente të palës kontraktuese të kërkuar, që i është lëshuar personit gjatë kohës së qëndrimit të tij/saj ose tranzitit përmes territorit të shtetit ose fotokopje të tyre;

e) biletat e udhëtimit;

f) fatura e përcaktuar e hotelit të personit;

g) certifikata e shkëmbimit të valutës;

h) deklarata të bëra me shkrim dore nga personi ose i regjistruar zyrtarisht nga autoritetet kompetente të palës kontraktuese kërkuese;

i) vendimet, protokollet dhe minutat e autoriteteve të vendeve të treta;

j) deklaratat nga dëshmitarët e regjistruar nga autoritetet kontraktuese;

k) informacioni që mund të kontrollohet që vërteton se personi në territorin e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar ka përdorur shërbimet e agjencisë së udhëtimit ose transferimi ilegal individual i personave nga kufiri shtetëror.

4. Provat nga paragrafi 3 i këtij neni shërbejnë si supozim i qëndrimit ose tranzitit nga territori i shtetit të palëve kontraktuese. Ky supozim mund të anulohet nga fakte të kundërta të siguruara nga autoritetet kompetente të palës kontraktuese të kërkuar që mund të nënshtrojë kontrolle shtesë.

Neni 5

Aplikimi për tranzitin e qytetarëve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi

1. Aplikimi i paraqitur për tranzit, në përputhje me nenin 9 të Marrëveshjes, duhet të përmbajë në veçanti informacionin e mëposhtëm:

a) Të dhëna në lidhje me identitetin dhe shtetësinë e personave që do të jenë tranzit;

b) Përligjje e paraqitjes së aplikimit;

c) Të dhëna në lidhje me dokumente të vlefshme udhëtimi që zotëron personi në tranzit;

d) Të dhëna në lidhje me udhëtimin, mjetet e transportit, koha dhe vendi i mbërritjes në shtetin e palës kontraktuese të kërkuar, shteti dhe vendi i destinacionit;

e) Të dhëna në lidhje me anëtarët e eskortës policore (identiteti, dokumenti i udhëtimit që disponojnë);

f) Të dhënat mbi biletat e udhëtimit.

2. Aplikimi për transferim duhet t'u paraqitet autoriteteve të specifikuara në nenin 7 të këtij protokolli të paktën shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara tranzitit me anë të e-mailit ose fax-it.

3. Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese duhet të informojnë direkt mbi kohën dhe mënyrën e tranzitit (p.sh. numri i udhëtimit, koha e mbërritjes dhe nisjes, emri dhe mbiemri i zyrtarëve shoqërues, targat e automjetit të regjistruar etj.).

4. Pala kontraktuese e kërkuar duhet të përgjigjet me shkrim ndaj aplikimit brenda një kohe sa më të shkurtër, gjithsesi, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga marrja e aplikimit. Nëse nuk merret një përgjigje për konfirmimin e pranimit brenda këtij afati kohor, transferimi do të konsiderohet i aprovuar.

Neni 6

Pikat e kalimit

Për zbatimin e marrëveshjes duhet të përdoren pikat e mëposhtme të kalimit të kufirit:

Në Republikën e Shqipërisë:

a) Pika e kalimit të kufirit Hani i Hotit
e-mail: hanihotit@mrp.gov.al

b) Pika e kalimit të kufirit Muriqan
e-mail: muriqan@mrp.gov.al

c) Komisariati i Policisë Kufitare "Aeroporti Ndërkombëtar-Rinas"
Tel/Fax: 00355 42 36 40 28
e-mail: rinas@mrp.gov.al

Në Bosnjë dhe Hercegovinë:

a) Pika e kalimit të kufirit "Aeroporti Ndërkombëtar-Sarajevë"
00 387 33 755 359
e-mail: sara dgs@bih.net.ba

b) Pika e kalimit të kufirit "Zupci-Herceg Novi"
00 387 59 480 790

c) Pika e kalimit të kufirit "Klobuk-Trebinje"
00 387 59 480 789

Neni 7

Autoritetet kompetente

Autoritetet kompetente për zbatimin e Marrëveshjes janë si më poshtë vijon:

Për Republikën e Shqipërisë:
Ministria e Brendshme
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Departamenti i Kufirit dhe Migracionit

Adresa: bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë, Shqipëri
Tel/Fax: 00355 4 22 69 32;
Tel: 00355 4 279 251/00355 4 279 253
Fax: 00355 4 279 263
e-mail: policiakufitare.migracioni@mrp.gov.al

Për Bosnje dhe Hercegovinën:
Për ripranimin e personave nga Bosnja dhe Hercegovina:
Ministria e Sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë
Trg Bosne i Hercegovine broj 1.
71 000 Sarajevo
Tel: 00387 33 492 476
Fax: 00387 33 492 794
e-mail:readmisija@msb.gov.ba

Për ripranimin e personave nga vendet e treta dhe personave pa shtetësi:
Ministria e Sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë
Shërbimi për Marrëdhëniet me Jashtë
Pijacna 6, 71000 Sarajevo, Bosnja dhe Hercegovina
Tel: +387 33 772 963
Fax: +387 33 772 966
e-mail: ivo.ramljak@sps.gov.ba

Neni 8
Gjuha e përdorur

Gjatë zbatimit të protokollit palët e kontraktuara duhet të komunikojnë në gjuhën angleze.

Neni 9
(Anekset)

Me qëllim zbatimin e marrëveshjes dhe protokollit duhet të përdoren anekset e mëposhtme:

Aneksi 1. Kërkesë për ripranim ose tranzit të personit/personave.

Aneksi 2. Dokumentet standarde të udhëtimit për të ripranuarit.

Neni 10
Dispozitat përfundimtare

1. Ky protokoll duhet të hyjë në fuqi në të njëjtën kohë me marrëveshjen.

2. Protokolli nuk duhet të zbatohet gjatë periudhës së pezullimit të marrëveshjes.

3. Protokolli duhet të skadojë njëkohësisht me marrëveshjen.

4. Ky protokoll duhet të amendohet me shkrim me pëlqimin e të dyja palëve kontraktuese.

Bërë në Sarajevë, më 24.3.2009, në dy dokumente origjinale, respektivisht në gjuhën shqipe, në gjuhën zyrtare të Bosnje dhe Hercegovinës (boshnjake, kroate dhe serbe) dhe në gjuhën angleze, secili nga këto tekste duhet të jetë i njëjtë dhe ligjërisht i vlefshëm. Në rast interpretimesh kontradiktore, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

ANEKSI 1

Autoriteti kërkues

Autoriteti kërkues

Lënda : Kërkesa për ripranim ose tranzit për një person ose persona
(plotëso si e zbatueshme)

1. Emri, mbiemri, gjinia, data dhe vendi i lindjes, kombësia
---
2. Adresa në vendin e origjinës
---
3. Dokumenti i udhëtimit (tipi dhe numri, vendi dhe data e lëshimit dhe skadimit)
---
4. Gjuhët me të cilat kupton dhe flet personi
---
5. Mënyrat e transportit dhe itinerari (ajër, tokë ose det)
---
6. Pikat e kalimit të kufirit, data dhe koha
---
7. Gjendja shëndetësore
---
8. Rikthim i shoqëruar me eskortë (nëse ka, data dhe zyrtarët që e shoqërojnë)
---
9. Masat e sigurisë që janë ndërmarrë në vendin e të rikthyerit/tranzit (nëse kërkohen)

---

10. Të dhënat e rrethanave lidhur me qëndrimin ilegal/hyrja në territorin e palës së kontraktuar.

Firma dhe vula e autoritetit kërkues

ANEKSI 2

Emri i shtetit

Dokumenti i udhëtimit
Për ripranimin e ----------
(fletorja zyrtare C274 19/09/1996 P 0018-0019

Nr.prot.
I vlefshëm për një udhëtim nga:

Vendi i nisjes:

Destinacioni:

Emri:

Emri i dhënë:

Data e lindjes:

Gjatësia:

Shenja të veçanta: Foto dhe vula

Kombësia:

Adresa në vendin e lindjes (nëse e di);

Autoriteti i lëshimit të dokumentit;

Lëshuar në datën;

Lëshuar në vendin;

Firma Autoriteti

Shënime:----------